



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 8
Papajtueshmëria ambientale**

1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë.

2. Këshillat gjatë emërimit, transferimit, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë të një magjistrati, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropacionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficenca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë.

3. Përbëjnë papajtueshmëri ambientale rrethanat e mëposhtme:

a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori, ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni;

- b) nëse gjyqtari që kërkon të caktohet në një gjykatë administrative të shkallës së parë, ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një gjyqtar tjetër, që ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe anasjelltas;
- c) nëse gjyqtari që kërkon të caktohet në seksionin civil të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një gjyqtar tjetër, që ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së apelit, që ka nën juridikcion gjykatën e zakonshme të shkallës së parë, si dhe anasjelltas;
- ç) nëse magjistrati që kërkon të caktohet në seksionin penal të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë dhe në prokurorinë në juridikcion të kësaj gjykate ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një magjistrat tjetër që ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në seksionin penal të gjykatës së apelit, që ka nën juridikcion gjykatën dhe prokurorinë e shkallës së parë, si dhe anasjelltas.

4. Magjistrati nuk mund të caktohet në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupzionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme nëse një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, ushtron funksionin në këto struktura.

5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për emërim, transferim, lëvizje paralele apo ngritje në detyre, duhet të paraqesë një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Nëse papajtueshmëria ambientale lind gjatë ushtrimit të funksionit, apo është krijuar përparrë hyrje në fuqi të këtij ligji, rregullat e parashikuara në këtë dispozitë nuk zbatohen. Në këtë rast, me pëlqimin e tij, magjistrati mund të caktohet në një seksion tjetër.

7. Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat në zbatim të këtij neni.”.

Neni 2

Pikat 7 dhe 8, të nenit 9, ndryshojnë si më poshtë:

“7. Magjistrati, pa cenuar afatet e përcaktuara dhe ushtrimin në mënyrë eficente të funksioneve, mund të marrë pjesë në veprimtari jashtë funksionit të papaguara, pa miratimin e Këshillit, vetëm në rastet kur:

- a) vepron si përfaqësues i gjyqësorit ose prokurorisë;
- b) bën deklarata publike të përgjithshme për çështje që prekin sistemin gjyqësor ose sistemin e prokurorisë;
- c) merr pjesë në diskutime për çështje të ligjit.

8. Magjistrati raporton, brenda muajit mars të çdo viti në Këshill, për natyrën dhe numrin e orëve, për veprimtaritë e papaguara jashtë funksionit, ku ka qenë i përfshirë në vitin paraardhës.”.

Neni 3

Pika 10, i nenit 23, ndryshohet si më poshtë:

“10. Magjistrati nuk mund të kryejë mungesa në detyrë, me përashtim të rasteve të justifikuara të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Kryetari, me vendim të arsyetuar me shkrim, zbret nga periudha e pushimit vjetor të të njëjtit vit, ditët e mungesës së pajustifikuar.

Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e Kryetarit në Këshillin përkatës brenda 7 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Nëse zbritja është e pamundur të realizohet, kryetari njofton Këshillin, i cili merr masa që magjistrati të mos paguhet për ditët që ka munguar.”.

Neni 4

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:
“a) arsyë të përkohshme personale ose familjare për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet.”.
2. Në pikën 3, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:
“a) në rastet e parashikuara në pikën 1, shkronja “a”, të këtij nenit, magjistrati kërkon ulje të ngarkesës në punë, nëse kjo nuk cenon interesat thelbësorë të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë eficiente të funksioneve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse;”.
3. Në pikën 4, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:
“b) rregulla për uljen e pagës dhe të përfitimeve të tjera, kur magjistrati ndodhet në kushtet e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij nenit, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit;”.

Neni 5

Në nenin 64 bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:
“c) mbush moshën 67 vjeç;”.
- b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë:
“4. Mandati i Prokurorit të Zyrës së Prokurorisë së Posacme mbaron në fundin e muajit në të cilin mbush moshën 67 vjeç, pavarësisht viteve që ai ka qenë në detyrë në këtë pozicion.”.
- c) Pika 5 ndryshohet si më poshtë:
“5. Statusi i magjistratit mbaron në fund të muajit në të cilin magjistrati mbush moshën 67 vjeç. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.”.

Neni 6

Pika 3, e nenit 78, ndryshohet si më poshtë:

- “3. Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tri kritere dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe të prokurorisë” duhet të janë vlerësuar “shumë mirë.”.

Neni 7

Pika 7, e nenit 95, ndryshohet si më poshtë:

- “7. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e vlerësimit të Këshillit në Gjykatën e Lartë, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkaqe ligjore të lidhura me zbatimin jo të njëjtë të ligjit.”.

Neni 8

Neni 101 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 101
Shkeljet disiplinore

1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:
 - a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;
 - b) gjatë ushtrimit të funksionit haptazi nuk i referohet ligjit ose fakteve për shkak të pakujdesisë së rëndë ose dashjes, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale.
2. Për të përcaktuar nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet si shkelje disiplinore, për shkak të pakujdesisë ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, duhet të merren në konsideratë kriteret e mëposhtme:
 - a) shkalla e pakujdesisë;
 - b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit;
 - c) përvuja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;
 - ç) dëmtimi ose mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi ose mosveprimi; si dhe
 - d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunkcionimin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë.

Neni 9

Neni 102 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 102
Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit

1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si vijon:
 - a) mosparaqitura e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tillë;
 - b) paraqitura e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nëse këto veprime:
 - i) nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj;
 - ii) bëhen me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synojnë shmangien e detyrimit ligjor të tij për shqyrtimin e çështjes ose të krijojnë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magjistrat tjetër;
 - iii) mosparaqitura menjëherë e kërkesës pasi është informuar për shkakun;
 - c) ndërhyrja ose çdo lloj ndikimi tjetër në ushtrimin e funksionit të një magjistrati tjetër;
 - ç) mospërmbushja, në mënyrë të përsëritur ose kur ka sjellë pasoja të rënda, e ushtrimit të funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit pa një shkak të ligjshëm;
 - d) vonesa dhe zvarritja e përsëritur dhe e pajustifikuar e veprimeve procedurale dhe/ose e akteve procedurale pa një shkak të ligjshëm;

- dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, të cilat krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore;
- e) angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë magjistratit ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të magjistratit;
- ë) vonesa e përsëritur dhe e pajustifikuar për fillimin e seancës gjyqësore ose zvarritje e hetimeve;
- f) mungesa e pajustifikuar në detyrë në përputhje me ligjin;
- g) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë dhe që lidhen me funksionet e magjistratit;
- gj) mosbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;
- h) mospërmbushja pa shkaqe të pajustikuara të detyrimit për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me ligj;
- i) mosnjoftimi nga magjistrati i drejtuesit të gjykatës ose prokurorisë dhe Këshillit, si dhe autoritetete kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet ose format e tjera të ndikimit nga magjistratët e tjerë, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektit e tjera;
- j) shkelja e rregullave të konfidencialitetit, të parashikuara nga legjislativi në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit të magjistratit;
- k) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ose çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij, sipas ligjit;
- l) mospërmbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve;
- ll) shkelja e detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar;
- m) bërja publike e mendimeve që janë dhënë nga magjistratët e tjerë gjatë procesit, të cilat nuk kanë marrë ende formën e një akti të disponueshëm për publikun;
- n) bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve për shtyp të magjistratit brenda kufijve të detyrës së tij;
- nj) mosnjoftimi i Këshillit për arsy që përbëjnë shkak për mbarimin e mandatit;
- o) mosnjoftimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit;
- p) mosnjoftimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimet e funksionit, si dhe në lidhje me çështje, për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magjistratit.
2. Sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë në veçanti, por pa u kufizuar veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, si vijon:
- a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i ligjit procedural dhe material ose zbatim i gabuar i ligjit procedural dhe material;
- b) parashtrimi i dukshëm, i shtrembüruar, i faktave dhe rrëthanave në aktet e nxjerra;
- c) nxjerra e akteve të paarsytuara ose që përbajnë, në pjesën arsyetuese, vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm, pa parashtruar rrëthanat e faktit, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar;
- ç) nxjerra e akteve ku pjesa përshkruese-arsyetuese parashtron rrëthana që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese të tij ose që nuk kanë lidhje me të;

d) marrja e vendimeve të paarsyetuara në mënyrë të qëllimshme, si rezultat i një interes personal apo shpërdorimi të detyrës.”.

Neni 10

Neni 103 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 103

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si vijon:

- a) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionimit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji;
- b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim arritjen e përfitimeve për vete ose për të tjerët;
- c) pranimi dhe ushtrimi i detyrave dhe veprimtarive jashtë funksionit, pa leje nga Këshilli;
- ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekt i procedimeve penale ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose krushqie me magjistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këtë persona;
- d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magjistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;
- dh) shkelje të detyrimeve ligjore, në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit, sipas ligjit;
- e) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.”.

Neni 11

Neni 104 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 104

Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale

1. Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë:

- a) veprimet, mosveprimet ose sjelljet, bazuar në faktet e pranuara nga gjykata, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, për të cilat Këshilli përkatës vendos masën disiplinore të parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “dh”, e këtij ligji, nëse ajo është në përputhje me parimin e proporcionalitetit;
- b) veprimet, mosveprimet ose sjellje të tjera, bazuar në faktet e pranuara nga gjykata, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjën “a”, të këtij nenit, që për nga natyra e tyre diskretojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë seriozisht besimin e publikut te sistemi gjyqësor dhe i prokurorisë.

2. Shkelje disiplinore janë edhe veprimet, mosveprimet ose sjelljet bazuar në faktet e pranuara nga organi kompetent me një vendim të formës së prerë, që për nga natyra e tyre diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë seriozisht besimin e publikut te sistemi gjyqësor dhe i prokurorisë, të cilat përbëjnë vepër penale, pavarësisht faktit që veprat penale është shuar, apo ndjekja penale nuk mund të fillohet ose nuk mund të vazhdojë, apo magjistrati është rehabilituar ose ka përfituar nga falja ose amnistia.”.

Neni 12

Pika 1, e nenit 141, ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjatë procedurës disiplinore, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të njohë dokumentet e dosjes së kësaj procedure dhe të marrë kopje të tyre. Brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës, Këshilli i siguron magjistratit kushtet për njohjen me dosjen dhe i vë në dispozicion kopje të dokumenteve.

E drejta e aksesit me dosjen mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm ndaj interesave të mëposhtëm:

- a) të drejtave themelore të një personi tjeter; ose
- b) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar; ose
- c) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- ç) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

E drejta e aksesit kufizohet për aq kohë sa ekzistojnë shkaqet e mësipërme. Në çdo rast, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka akses në dosje para se Këshilli të marrë vendimin.”.

Neni 13

Neni 152 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 152 Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor

1. Kur Këshilli është i bindur se vazhdimi në detyrë i magjistratit, për të cilin është paraqitur kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas nenit 138, të këtij ligji, dëmon rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose e diskrediton rëndë figurën dhe pozicionin e magjistratit, mund të vendosë pezullimin e tij nga detyra.

2. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për çështjen përkatëse, përvçe kur Këshilli vendos të heqë pezullimin kur kushtet e përmendura në pikën 1 pushojnë së ekzistuari.”.

Neni 14

Në nenin 153 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Shkronjat “c” dhe “ç” shfuqizohen.

Neni 15

Neni 156 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 156
Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit

1. Pezullimi i magjistratit, i parashikuar në nenet 151 dhe 152, të këtij ligji, vendoset për një periudhë të caktuar kohe dhe nuk mund të vazhdojë nëse arsyet e pezullimit, të përcaktuara në nenet 67, 151 dhe 152, të këtij ligji, pushojnë së ekzistuari.
2. Këshilli kryesisht, me kërkesë të inspektorit ose të magjistratit, mund të rishikojë pezullimin e parashikuar në nenet 67, 151 dhe 152, të këtij ligji, dhe të vendosë sipas rastit:
 - a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
 - b) revokimin e pezullimit; ose
 - c) lënien në fuqi të pezullimit.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën _____ 2019